REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKISË DIVJAKË
DREJTORIA E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE KOMUNALE

Nr. 3262/17 **Prot.** **Divjakë, më** 20.10.**2026.**

PROJEKT VENDIM
Nr. 95, datë 20.10.2026

PËR MIRATIMIN E VENDOSJES SË SISTEMIT TË KAMERAVE TË MONITORIMIT PËR MBROJTJEN E KOSHAVE TË MBETJEVE URBANE NË PIKAT KRYESORE TË TERRITORIT TË BASHKISË DIVJAKË

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenet 8, 23 dhe 54, shkronja "k"; të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar; të ligjit nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale"; si dhe të Udhëzimit nr. 03, datë 30.04.2025, "Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video-survejimit", i propozojmë Këshillit Bashkisë Divjakë, me datë 23.10.2026:

1. Të miratoj në parim vendosjen e një sistemi kamerash monitorimi, të përbërë nga 30 (tridhjetë) pika monitorimi, në pikat kryesore të grumbullimit të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Divjakë, me qëllim mbrojtjen e koshave dhe pajisjeve në funksion të shërbimit të pastrimit dhe administrimit të mbetjeve urbane.

2. Sistemi i kamerave do të shërbejë për monitorimin e gjendjes fizike të koshave, evidentimin dhe dokumentimin e rasteve të dëmtimit, thyerjes, zhvendosjes së paautorizuar apo veprimeve të tjera që cenojnë integritetin dhe përdorimin normal të tyre, si dhe për mbështetjen e masave për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të dëmtuara.

3. Vendndodhja konkrete e 30 (tridhjetë) pikave të monitorimit të përcaktohet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Divjakë, në bashkëpunim me shoqërinë "RRJELA" sh.p.k., duke u bazuar në nevojat e shërbimit dhe rëndësinë e pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane.

4. Instalimi, administrimi dhe përdorimi i sistemit të kamerave të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, informimin e publikut, kufizimin e aksesit te personat e autorizuar dhe ruajtjen e pamjeve filmike vetëm për periudhën e nevojshme dhe të ligjshme.

5. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të Bashkisë Divjakë: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, Agjencia e Shërbimeve Komunale, RRJELA shpk, sipas kompetencave dhe përgjegjësive përkatëse, për marrjen e masave të nevojshme për instalimin, funksionimin dhe administrimin e sistemit të monitorimit.

6. Shpenzimet për realizimin, instalimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të kamerave të monitorimit do të përballohen nga të ardhurat e veta të shoqërisë "RRJELA" sh.p.k., me ortak të vetëm Bashkinë Divjakë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë, mundësitë financiare dhe legjislacionin në fuqi.

7. Për zbatimin e këtij projekt - vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Divjakë, strukturat përgjegjëse të Bashkisë Divjakë: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, Agjencia e Shërbimeve Komunale, RRJELA shpk.

Drejtoria Juridike Prokuirmeve
dhe Menaxhimit të Aseteve
Përgjegjësi
Andi Bullari

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Komunale
Eridian Hoxha

Drejtoria e Planifikimit
dhe Zhvillimit te Territorit
Ardit Janko

Shoqëria "RRJELA" SHPK
Bruno Priffi

KRYETARI
JOSIF GORREA